

# KRITIKË HISTORIOGRAFIKE

Flamur Hadri

## GJERGJ KASTRIOTI — SKËNDERBEU DHE EPOKA E TIJ NË SINTEZAT HISTORIKE

Sintezat historike, në të cilat ku më pak e ku më shumë flitet për Gjergj Kastriotin — Skënderbeun dhe Lëvizjen mesjetare shqiptare, janë objekt interesimi në këtë punim. Këtu do të bëjmë fjalë për tetë sinteza historike.

### **I. Konstantin Jiriçeku në historinë e serbëve për epokën e Skënderbeut**

Libri i Konstantin Jiriçekut, që u botua në Beograd më 1923, zë vend me rëndësi në historiografinë serbe dhe në atë jugosllave. Në të gjejmë të dhëna interesante për historinë mesjetare shqiptare, e poashtu edhe për epokën e Gjergj Kastriotit — Skënderbeut.

Konstantin Jiriçeku me plot të drejt thekson se gjatë jetës së Gjergj Kastriotit — Skënderbeut, populli shqiptar në tri raste para mureve të Krujës theu ushtrinë osmane por ai gabon kur thyerjen e fundit të ushtrisë osmane te Kruja, ia atribuon „epidemisë së kolerës”.<sup>1</sup> Ky autor e çmoi drejt fuqinë e Lëvizjes mesjetare shqiptare.

Është me rëndësi të madhe fakti se Jiriçeku nuk ecë rrugës së atyre historianëve borgjezë serbë, të cilët, sipas një ligji të pashkruar, Gjergj Kastriotin — Skënderbeun e konsideronin serb. Përkundër kësaj Jiriçeku pohon përkatësinë shqiptare të Skënderbeut.<sup>2</sup>

Ndihma që Gjergj Kastrioti i dhe Ferdinandit I ishte me rëndësi të madhe për ruajtjen e fronit mbretëror të tij.<sup>3</sup> dhe i përgjigjet plotësisht të vërtetës historike.

Nuk ka dyshim se Gjergj Kastrioti — Skënderbeu ishte në marrëdhënie të mira edhe me popullin boshnjak, gjë që e vërejtë mirë edhe

<sup>1</sup> Konstantin Jiriček. *Istoriya Srba*, Druga sveska, Beograd 1923, 189.

<sup>2</sup> *Po aty.*

<sup>3</sup> *Po aty.*

Jiriçeku, i cili pohon se boshnjakët shihnin në Lëvizjen mesjetare shqiptare aleatin potencial në luftë kundër Perandorisë Osmane.<sup>4</sup>

Kjo rrjedh nga fakti se Lëvizja shqiptare në epokën e Skënderbeut ishte faktor jashtëzakonisht i rëndësishëm jo vetëm për mbrojtjen e pavarësisë së Shqipërisë, por edhe të civilizimit Evropian.

Konstantin Jiriçeku e ngatërron Nikollën me Lekë Dukagjinin, duke pohuar se Lekë Zaharinë e vrau Nikolla e jo Lekë Dukagjini.<sup>5</sup>

I përgjigjet të vërtetës mendimi i këtij autori se në mes Gjergj Kastriotit — Skënderbeut dhe Republikës së Venedikut shpërtheu konflikti rreth qyteteve të Danjit dhe Drishtit, por nuk mund të pranohet pohimi i tij se Drishti ishte „qytet serb”.<sup>6</sup> Nuk është vërtetuar shkencorisht se Skënderbeu, më 1449, „i paguante tribut sulltanit”.<sup>7</sup> I përgjigjet plotësisht të vërtetës historike pohimi se Gjergj Kastrioti — Skënderbeu dhe Janosh Huniadi ishin në marrëdhënie të mira dhe se Gjergj Kastrioti dëshironte t’i vijë në ndihmë në Betejën e Varnës më 1444,<sup>8</sup> por kjo gjë nuk u realizua për arsye të njohur në shkencën historike.

## II. Historia e Jugosllavisë (botimi i vitit 1933) për epokën e Skënderbeut

Kjo histori, që u botua në Beograd më 1933, është interesante sepse në te gjejmë të dhëna edhe për epokën e Gjergj Kastriotit — Skënderbeut.

Ka të bëjë me të vërtetën historike pohimi në këtë libër se lidhja e marrëveshjes në mes të Lëvizjes shqiptare dhe Republikës së Venedikut u bë sepse Gjergj Kastrioti — Skënderbeu dëshironte t’i shmangej luftës në dy fronte.<sup>9</sup> Kjo marrëveshje u lidh pas dëmshpërblimit në të mirë të Lëvizjes shqiptare dhe të udhëheqësit të saj. Është me vend pohimi se marrëdhëniet e mira midis Alfonsit V dhe Skënderbeut ndikuan në qëndrimin e Republikës së Venedikut kundër Lëvizjes shqiptare.<sup>10</sup> Në këtë drejtim ndihmuan edhe humbjet në planin ushtarak e politik që i pësoi Republika e Venedikut nga Lëvizja shqiptare.

Nuk ka të bëjë me të vërtetën historike mendimi se pas rënies së Perandorisë Bizantine, të gjitha shtetet ballkanike së shpejti ranë nën sundimin osman,<sup>11</sup> sepse Shqipëria bie përfundimisht në fillim të shekullit XVI.

<sup>4</sup> Po aty, 178.

<sup>5</sup> Po aty, 152.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Po aty, 154.

<sup>9</sup> *Istoriya Jugoslavije*, Beograd 1933, 234.

<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> Po aty, 237.

### III. Georgije Ostrogorski në historinë e Bizantit (dy botime) për epokën e Skënderbeut

Në librin e këtij bizantologu të dalluar botëror, që për të parën herë u botua në Beograd më 1947, vihet në dukje se lufta për çlirimin e Shqipërisë, nën udhëheqjen e Skënderbeut, kundër Perandorisë Osmane mori përmasa të gjera dhe ishte pakompromis gjatë viteve 1443-1468, prandaj në tërë botën e krishterë ngjallte entuziazëm të madh.<sup>12</sup> Në ato kohë Evropa kishte shpresë të madhe në Koalicionin Danubian dhe në Lëvizjen çlirimtare shqiptare.<sup>13</sup>

Po këto mendime janë edhe në botimin e dytë të këtij libri, përkatësisht edhe këtu zotëron mendimi objektiv mbi epokën e Gjergj Kastriotit — Skënderbeut.<sup>14</sup>

### IV. Historia e popujve të Jugosllavisë (botimi i vitit 1953) për epokën e Skënderbeut

Në këtë libër, që u botua në Beograd më 1953, pohohet se në Shqipëri iu bë rezistencë e madhe ushtrisë osmane, menjëherë pas kthimit të Gjergj Kastriotit Skënderbeut në mëmëdhe.<sup>15</sup>

I përgjigjet të vërtetës pohimi se Gjergj Kastrioti — Skënderbeu e vazhdoi luftën, të cilën e bënë para tij Gjergj Arianiti dhe feudalët e tjerë shqiptarë.<sup>16</sup>

Nuk mjafton të thuhet, siç bëhet në këtë libër, se Gjergj Kastrioti u arratisë nga ushtria osmane,<sup>17</sup> por duhej të ipeshin shënime më të hollësishme, duke përfshirë edhe kontributin që i dhanë shqiptarët luftës së Koalicionit Danubian. Nuk i përgjigjet të vërtetës pohimi se Gjergj Kastrioti u dorëzua peng kur ishte fëmijë.<sup>18</sup> Edhe pse Gjergj Kastrioti dhe Gjurgj Brankoviqi ishin në marrëdhënie të mira dhe i ndihmonin njëri-tjetrit, duke luftuar kundër të njëjtit armik, prapëseprapë nuk mund të thuhet se ka ekzistuar bashkëpunimi direkt në mes tyre kundër Republikës së Venedikut, siç thuhet në këtë sintezë.<sup>19</sup> Nuk ka ekzistuar ndonjë koordinim i aksioneve në mes të Lëvizjes shqiptare dhe Republikës së Venedikut, siç qëndron në këtë sintezë.<sup>20</sup> Është e vërtetë se marrëdhëniet në mes palëve të përmendura patën shumë oscilime, por edhe në kohën e bashkëpunimit më dinamik këto kufizoheshin në respektimin e interesave reciproke dhe nga ndonjëherë përfshinin edhe ndihmën simbolike materiale, njerëzore dhe morale.

<sup>12</sup> Dr. Georgije Ostrogorski, *Istorija Vizantije*, Beograd 1947, 286.

<sup>13</sup> *Po aty*, 287.

<sup>14</sup> Georgije Ostrogorski, *Istorija Vizantije*, Beograd 1959, 523.

<sup>15</sup> *Istorija naroda FNRJ I*, Beograd 1953, 439.

<sup>16</sup> *Po aty*, 465.

<sup>17</sup> *Po aty*.

<sup>18</sup> *Po aty*.

<sup>19</sup> *Po aty*.

<sup>20</sup> *Po aty*.

I përgjigjet të vërtetës historike pohimi se Skënderbeu kishte marrëdhënie të mira me Hungarinë dhe Mbretërinë e Napolit.<sup>21</sup> Poashtu është i vërtetë edhe pohimi se Lëvizja shqiptare me rezistencën e vet lidhte për Shqipëri forcat osmane dhe, duke luftuar heroikisht, shqiptarët magjepsen tërë Evropën Perëndimore.<sup>22</sup>

I përgjigjet të vërtetës historike pohimi se përpjekjet e ushtrisë osmane për ta pushtuar Krujën dhe qytetet e tjera shqiptare, nuk patën sukses, por është në kundërshtim me të vërtetën shkencore pohimi se rezistenca e popullit shqiptar filloi të dobësohet pas sulmeve të njëpasnjëshme të ushtrisë osmane,<sup>23</sup> aq më parë kur dihet mirëfilli që tre mbrojtjet e njëpasnjëshme të Krujës ishin rezultat i forcimit të lëvizjes çlirimtare shqiptare.

## V. Historia e popujve Jugosllavë (botimi i vitit 1963, I) për epokën e Skënderbeut

Në këtë libër, që doli në Beograd më 1963, vihet në dukje se Perandoria Osmane e linte të qetë Gjuragj Brankoviçin, sepse ishte manash nga armiqësitë hungarezo-turke, dhe, në përputhje me këtë, ai nuk mori pjesë në Betejën e Varnës (1444) as në atë të Kosovës (1448), në të cilat u thyen ushtritë hungareze.<sup>24</sup> Këto të dhëna janë në lidhje implicite me ngjarjet në Shqipërinë e asaj kohe. Në këtë libër nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta për epokën e Skënderbeut.

## VI. Libri „Iz istorije Albanaca” për epokën e Skënderbeut

Momçillo Spremiqi, njëri nga bashkëautorët e këtij libri, që doli në Beograd më 1969, vë në dukje se sulmet e shpeshta osmane kontribuan në forcimin e rezistencës shqiptare kundër tyre.<sup>25</sup> S’ka dyshim se edhe ky moment, ndonëse jo i vetmi, kontribuoi në forcimin e kësaj rezistence, por dëshira për liri dhe pavarësi ishte shkaku kryesor në lindjen dhe forcimin e qëndresës së popullit shqiptar kundër pushtuesit osman. Nuk është i vërtetë pohimi se Skënderbeu u turqizua,<sup>26</sup> ndonëse iu imponua feja islame. Nuk është i plotë pohimi se Skënderbeu së bashku me 300 shqiptarët e lëshoi ushtrinë osmane gjatë depërtimit të ushtrisë së Koalicionit Danubian kah Bullgaria (1443),<sup>27</sup> por u tërhoq me qëllin që kështu t’i vijë në ndihmë në mënyrë indirekte Janosh Huniadit dhe të shkojë sa më parë në Shqipëri për të organizuar rezistencën antiturke.

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Po aty, 466.

<sup>24</sup> *Pregled istorije jugoslovenskih naroda, I*, Beograd 1963, 10.

<sup>25</sup> *Iz istorije Albanca (M o m ç i l o S p r e m i ç, Albanija od XIII do XV veka)*, Beograd 1969, 40.

<sup>26</sup> Po aty.

<sup>27</sup> Po aty.

I përgjigjet plotësisht të vërtetës historike pohimi se pas kthimit të Gjergj Kastriotit — Skënderbeut në Shqipëri filloi lufta e madhe e popullit shqiptar kundër perandorisë Osmane.<sup>28</sup> Gjithashtu i përgjigjet të vërtetës edhe pohimi se Skënderbeu asnjëherë nuk i shkëputi lidhjet me familjen e vet, por i mbeti besnik mëmëdheut dhe popullit nga gjiu i të cilit doli.<sup>29</sup>

Edhe pohimi se në Kuvendin e Lezhës u lidh aleanca për luftë kundër Prenandorisë Osmane i përgjigjet të vërtetës historike.<sup>30</sup> Është në pajtim me të vërtetën edhe mendimi se Republika e Venedikut bënte politikë dyfytësre ndaj Lëvizjes shqiptare dhe Gjergj Kastrioti — Skënderbeut.<sup>31</sup> Është i saktë edhe mendimi se Gjergj Kastrioti ishte në marrëdhënie miqësore me Gjuragj Brankoviçin, por nuk i përgjigjet të vërtetës historike pohimi se ka ekzistuar koordinimi i aksioneve në mes të tyre kundër Republikës së Venedikut gjatë rrethimit të Danjit.<sup>32</sup>

Qëndron pohimi se Skënderbeu pati dëshirë t'i vijë në ndihmë Koalicionit Danubian edhe në betejën që u zhvillua në Kosovë më 1448.<sup>33</sup> Po kështu qëndron edhe pohimi se rrethimi i parë i Krujës, në të cilin morën pjesë Murati II dhe Mehmeti II, u thye nga ushtria e Lëvizjes çlirimtare shqiptare.<sup>34</sup> Nuk përputhet me të vërtetën historike pohimi se Skënderbeu u bë vasal i Mbretërisë së Napolit në kuptimin e plotë të fjalës, siç thekson Momçillo Spremiqi.<sup>35</sup>

Ka të drejt Momçillo, Spremiqi kur vënë në dukje se Shqipëria ishte i vetmi shtet që e mbrojti pavarësinë e vet, ndërsa të gjitha shtetet ballkanike binin njëra pas tjetrës nën thundrën e Perandorisë Osmane.<sup>36</sup>

Është në pajtim me të vërtetën historike edhe pohimi se ushtria e Lëvizjes shqiptare i ndihmoi Ferdinandit I të qëndrojë në fron.<sup>37</sup> Është i saktë konstatimi se Skënderbeu është dashur të jetë pjesëmarrës në luftën kryqëzatore kundër perandorisë Osmane, të cilën e planifikoi Papa Piu II.<sup>38</sup>

Është në pajtim me të vërtetën shkencore edhe fakti mbi vendosmërinë e popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit — Skënderbeut, të qëndrojë në luftë kundër Perandorisë Osmane.<sup>39</sup>

Në pajtim me të vërtetën historike është edhe pohimi se Mehmeti II u thye dy herë te muret e Krujës, më 1466 dhe më 1467, edhe pse ushtria e tij ndërmoi represalje të mëdha ndaj popullsisë.<sup>40</sup> Qëndron e dhëna se Gjergj Kastrioti vdiq më 17 janar të vitit 1468.<sup>41</sup> Është i saktë pohimi se Skënderbeu

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> Po aty.

<sup>31</sup> Po aty, 40-41.

<sup>32</sup> Po aty, 41.

<sup>33</sup> Po aty.

<sup>34</sup> Po aty.

<sup>35</sup> Po aty.

<sup>36</sup> Po aty.

<sup>37</sup> Po aty, 42.

<sup>38</sup> Po aty.

<sup>39</sup> Po aty.

<sup>40</sup> Po aty.

<sup>41</sup> Po aty.

edhe pse vendet tjera nuk i dhanë ndihmë të konsiderueshme<sup>42</sup> me forca të veta bëri luftë heroike kundër Perandorisë Osmane.

Pohimi i këtij autori mbi vasalitetin e Gjergj Kastriotit — Skënderbeut ndaj Perandorisë Osmane nuk mbështetet në të vërtetën historike.<sup>43</sup> Është i njëanshëm pohimi se Lëvizja çlirimtare shqiptare, nën udhëheqjen e Skënderbeut, e shtyri për një kohë pushtimin e Shqipërisë.<sup>44</sup> Duhej të theksohe se në këtë periudhë historike u krijuan kushte të mira për mbrojtjen e Evropës Perendimore. Përkundër vdekjes së Skënderbeut, e cila solli dëshprim të madh në radhët e Lëvizjes shqiptare, madje edhe përkundër dobësimit të potencës njerëzore e materiale të vendit, Shqipëria i bëri ballë ekspeditave osmane gjer në fillim të shek. XVI.<sup>45</sup> Edhe pohimi se Gjurgj Brankoviçi mori pjesë „në ndarjen e domeneve shqiptare”,<sup>46</sup> nuk ka të bëjë me të vërtetën historike.

## VII. Historia e Malit të Zi për epokën e Skënderbeut

Në hartimin e kësaj sinteze historike, që doli në Titograd më 1970, mori pjesë edhe Ivan Bozhiqi. Ai është autor i pjesës, ku bëhet fjalë edhe për epokën e Skënderbeut.

Është i saktë pohimi se pas largimit të ushtrisë osmane, Skënderbeu mori Krujën dhe filloi spastrimin e vendit nga pushtuesit turk.<sup>47</sup>

I përgjigjet të vërtetës historike pohimi se Republika e Venedikut bënte politikë dyfyturëshe ndaj Gjergj Kastriotit — Skënderbeut dhe Lëvizjes shqiptare, por nuk qëndron mendimi se gjëja Skënderbeu vasalitetin ndaj sulltanit donte ta ndërrojë për atë ndaj Venedikut”.<sup>48</sup> Nuk i përgjigjet të vërtetës as pohimi se Nikollë Dukagjini ishte gjëja vasal i Lekë Zaharisë, por qëndron e dhëna se Gjergj Kastrioti ishte në marrëdhënie të mira edhe me Cërnojeviqët.<sup>49</sup>

Më në fund, Ivan Bozhiqi e ngatërroi Nikollën me Lekë Dukagjinin, duke theksuar se Lekë Zaharinë e vrau Nikollë Dukagjini,<sup>50</sup> e jo Lekë Dukagjini.

## VIII. Historia e Jugosllavisë (botimi i vitit 1973) për epokën e Skënderbeut

Në këtë sintezë historike, që doli në Beograd më 1973, ka të dhëna për Gjergj Kastriotin — Skënderbeun dhe Lëvizjen shqiptare.

<sup>42</sup> *Po aty*, 43.

<sup>43</sup> *Po aty*.

<sup>44</sup> *Po aty*, 43-44.

<sup>45</sup> *Historia e Shqipërisë, I*, Tiranë 1969, 329-330.

<sup>46</sup> *Si shën.*, 25, 40.

<sup>47</sup> *Istorija Crne Gore*, knj. 2, tom II, Titograd 1970, 215.

<sup>48</sup> *Po aty*, 215-221.

<sup>49</sup> *Po aty*, 214.

<sup>50</sup> *Po aty*.

Nuk i përgjigjet të vërtetës pohimi se përhapja e rezistencës edhe në Shqipëri ishte rezultat i fitoreve të Koalicionit Danubian.<sup>51</sup> Ky element ishte i rëndësishëm, por sukcesi i luftës së popullit shqiptar në këtë periudhë historike nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë të njëanëshme. Është e vërtetë se Skënderbeu e shfrytëzoi Betejën e Nishit për tu kthyer në Shqipëri, por ai shfrytëzoi faktorët e brendshëm e të jashtëm dhe ia doli në krye të qëndrojë dhe udhëhoqi me sukses Lëvizjen çlirimtare kundër pushtuesit osman më 1443-1468.

Lëvizja çlirimtare shqiptare në epokën e Gjergj Kastriotit — Skënderbeut ka rëndësi të brendshme dhe ndërkombëtare. Rëndësia e brendshme e saj shfaqet në çlirimin e Shqipërisë, në formimin e shtetit shqiptar dhe në njësimin e fuqive shqiptare në luftë kundër perandorisë Osmane. Rëndësia ndërkombëtare e Lëvizjes shqiptare shfaqet në faktin se Perandoria Osmane nuk ishte në gjendje t'i përdorë të gjitha fuqitë e veta për pushtimin e Evropës, sepse rezistenca e popujve të Evropës Juglindore, përkatësisht Lëvizja çlirimtare shqiptare, ishin mburojë e civilizimit evropian të Perëndimit. Rëndësia e rezistencës së popujve ballkanikë kundër pushtuesit osman i tejkalon kufijtë e këtij Gadishulli. Në kuadër të rezistencës së popujve të këtyre vendeve, Lëvizja çlirimtare shqiptare, nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit — Skënderbeut, ka rëndësi të madhe.<sup>52</sup> Prandaj teza e përmendur duhet të ndryshohet rrënjësisht, aq më parë sepse është lëshim serioz.

Nuk i përgjigjet të vërtetës edhe pohimi se Gjergj Kastrioti u turqizua në pallatin e sultanit.<sup>53</sup> Nëse ky udhëheqës i Lëvizjes shqiptare kaloi në fenë islame, kjo nuk do të thotë se u turqizua. Faktet se ai ishte në Shqipëri edhe para vitit 1443 dhe se më vonë u bëri rezistencë heroike pushtuesit osman, flasin dukshëm për të kundërtën.<sup>54</sup>

I përgjigjet plotësisht të vërtetës historike pohimi i këtij autori se Gjergj Kastrioti — Skënderbeu, në krye të Lëvizjes shqiptare, bëri luftë heroike kundër Perandorisë Osmane, gjer në vdekje.<sup>55</sup>

## Përfundime

Epoka e Skënderbeut në sintezat historike trajtohet në mënyra të ndryshme.

Sintezat e historiografisë borgjeze këtë epokë e trajtojnë në mënyrë subjektive dhe idealiste. Vepra e Konstantin Jiriçekut dallohet nga të tjerat, sepse në të gjejmë të dhëna interesante, që duhet shfrytëzuar nga historiografia me rastin e hartimit të monografive dhe të sintezave historike.

<sup>51</sup> *Istoriya Jugoslavije*, treçe izdanie, Beograd 1973, 104.

<sup>52</sup> A l i H a d r i, *Kritikë historiografike*, I, Shkup 1973, 58.

<sup>53</sup> Si shën. 51.

<sup>54</sup> Si shën. 52.

<sup>55</sup> Si shën. 51.

Sintezat historike të pasluftës janë me interes për historiografinë tonë, sepse në to Lëvizja shqiptare në epokën e Skënderbeut trajtohet dhe interpretohet në mënyrën më objektive shkencore. Mirëpo, edhe në këto sinteza hasim në aso interpretimesh, që janë marrë nga historiografia e vjetër.

Duke marrë atë që është pozitive nga historiografia serbe dhe duke hedhur posht atë që është negative në këtë historiografi lidhur me Lëvizjen çlirimtare shqiptare dhe udhëheqësin e saj Gjergj Kastriotin — Skënderbeun, shkenca historike do të shkojë përpara në hulumtimin dhe ndriçimin e historisë mesjetare shqiptare dhe të marrëdhënieve me popujt fqinj, e veçanërisht të vendit dhe rolit të qëndresës shqiptare në krye me Skënderbeun në kuadër të historisë së Ballkanit dhe të Evropës.

*Flamur Hadri*

#### GJERGJ KASTRIOT — SKENDERBEU ET SON EPOQUE DANS LES SYNTHESES HISTORIQUES

##### R é s u m é

Dans cette étude l'auteur parle des synthèses historiques qui parlent de Gjergj Kastriot-Skenderbeu et du Mouvement albanais du Moyen âge.

L'époque de Skenderbe dans les synthèses historiques est traitée de différentes manières.

Les synthèses de l'historiographie bourgeoise traitent cette époque d'une manière subjective et idéaliste. L'oeuvre de Konstantin Jiriček diffère des autres, car on y trouve des données intéressantes avec lesquelles doit s'en servir l'historiographie à l'occasion de la rédaction des monographies et des synthèses historiques.

Les synthèses historiques après la guerre sont du intérêt pour notre historiographie, car le Mouvement albanais de l'époque de Skenderbe y est traité de la manière la plus objective scientifique. Mais, on y trouve aussi de telles interprétations prises de l'ancienne historiographie.

En prenant ce qui est positif de l'historiographie serbe et en rejetant ce qui est négatif dans cette historiographie concernant le Mouvement de libération albanaise et son chef Gjergj Kastriot-Skenderbe, la science historique avancera dans les recherches et dans l'illumination de l'histoire albanaise du Moyen âge et des rapports avec les peuples voisins, particulièrement des autochtones et du rôle de la résistance albanaise dirigée par Skenderbe en cadree de l'histoire des Balkans et de l'Europe.